



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 8.3.2023

Nr: 146

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E KOMITETIT NISMËTAR, QË DO ORGANIZOJË
PUNËN PËR PARAQITJEN E Z. ILJAN GJERGJI NASTU, SI KANDIDAT I PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT
NE ZONËN ZGJEDHORE BASHKIA KORÇË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE
TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë, 8.3.2023 në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1380 Prot datë 6.3.2023 me:

Kërkues: 1-Tefta Gaqo Nastu, 2-Xhensila Josif Qako, 3-Stiven Arben Elezi, 4-Edmir Azem Burnazi, 5-Gjergji Ilia Nastu, 6-Juxhin Nazar Mano, 7-Elvis Nesti Mitrollari, 8-Leonard Agron Mucollari, 9-Erion Fredi Panariti.

Objekti: Kërkohej regjistrimi i Komitetit Nismëtar, për paraqitjen e z. Iljan Gjergji Nastu, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Korçë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Baza ligjore: Neni 70 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 Maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Në referim të nenit 70, grupi i zgjedhësve i përbërë nga zj. Tefta Gaqo Nastu, 2-Xhensila Josif Qako, 3-Stiven Arben Elezi, 4-Edmir Azem Burnazi, 5-Gjergji Ilia Nastu, 6-Juxhin Nazar Mano, 7-Elvis Nesti

Data: 8.3.2023 Nr: 146
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e Komitetit Nismëtar që do të organizojë punën për paraqitjen e z. Lazjon Vangjel Petri, kandidat i propozuar nga zgjedhësit Bashkia Korçë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

Mitrollari, 8-Leonard Agron Mucollari, 9-Erion Fredi Panariti, është drejtuar KQZ-së me kërkesën me nr.1380 Prot, datë 6.3.2023, për regjistrimin e Komitetit Nismëtar të formuar prej tyre. Kërkuesit kanë depozituar emrat dhe nënshkrimet e tyre si dhe i kanë bashkëlidhur kërkesës kopjet e dokumentave të identifikimit.

Nga verifikimi i emrave të kërkuesve në ekstratin e përbërësve zgjedhorë rezulton se janë zgjedhës të zonës zgjedhore Bashkia Korçë, dhe me vullnet të lirë kanë vendosur krijimin e Komitetit Nismëtar për organizimin e punës për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin z. Iljan Gjergji Nastu.

Kërkesa e paraqitur prej këtyre zgjedhësve, përmbush kriterin dhe afatin e përcaktuar në nenin 70, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, nenin 70, pika 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar,

VENDOSA:

1. Regjistrimin e Komitetit Nismëtar që do të organizojë punën për paraqitjen e z. Iljan Gjergji Nastu, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Korçë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI